



SHOQATA PRO-EKSPORT ALBANIA

Nr. 83/2023 Prot.

Tiranë, më 25 Shtator 2023

Lënda: *LIGJIN Nr. 15/2019 PËR NXITJEN E PUNËSIMIT - Punësimi i personave nga grupet e veçanta, detyrim për Punëdhënësit Publik dhe Privat.*

Z. Ervin Mete

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Znj. Olta Manjani

Zëvendësminister i Financave dhe Ekonomisë

Z. Klevis Hysa

Drejtor i Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit (AKPA)

Për dijeni:

Znj. Delina Ibrahimaj

Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

I nderuar Zoti Ministër,

Shoqata “Pro-Eksport Albania” kërkon të shprehë shqetësimin e saj mbi një event që po ndodh kohët e fundit lidhur me *LIGJIN Nr. 15/2019 PËR NXITJEN E PUNËSIMIT- Punësimi i personave nga grupet e veçanta, detyrim për Punëdhënësit Publik dhe Privat.*

Spektori Manufakturë i veshjeve dhe këpucëve po kalon një situatë shumë alarmante siç edhe Ju jeni në dijeni me rënie të theksuar të porosive/prodhimet për eksport (të dhënat Instat muaji Gusht 2023 -21,9% në krahasim me muajin Korrik 2023), kursi i këmbimit, rritja e kostove, mungesë e theksuar likuiditeti, amortizimi i impianteve prodhuese e një mori problematika të tjera që ky sektor ka.

Duke vënë theksin me sa parashtroam më sipër, shtohet si kosto dhe detyrimi ligjor i Ligjit nr. 15/2019 e cila përtej impaktit social dhe ndihmës për grupet e veçanta që secili nga Ne e mirëpret dhe ka qenë gjithmonë kontribues, shton kostot e bizneseve të

PRO-EKSPORT ALBANIA

Cel:00355/698364328

Email: kryetari@fason.al

Web: www.fason.al

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Ndertesë n° 38 - Kati i 3 (Trete)- Hyrja n°1/Ap. n°3
Tirane, Shqipëri



sektorit në rreth 8%, pa llogaritur këtu investimet e nevojshme për të krijuar ambiente pune të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar në fabrikat prodhuese.

Në pikëpamjen tonë mungon analiza e faktibilitetit referuar sektorit tonë dhe situata është e papërshtatshme për të vendosur një “Taksë sociale të detyrueshme”, kur treguesit ekonomik janë perceptori dhe çertifikuesi i depresionit ekonomik që ka kapluar.

Në këto kushte kërkojmë nga ana Juaj:

- Reflektimin e duhur dhe ndalimin e aplikimit për një moment të dytë;
- Krijimin e një tavoline teknike (ose edhe në Këshillin Kombëtarë të Punës) ku diskutimet dhe analiza ti lënë vendin më pas aplikimit të tij.

Vleresojmë bashkëpunimin Institucional me MFE-n dhe AKPA-n deri më sot, po ashtu jemi të bindur se me Ju do arrij në nivele më të larta, që edhe janë pritshmëritë tona.

Me respekt dhe besim se do të merren në konsiderate, Ju urojmë suksese në misionin tuaj.

Kryesia e Pro-Eksport Albania

PRO-EKSPORT ALBANIA
Cel:00355/698364328
Email: kryetari@fason.al
Web: www.fason.al

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Ndertesa n° 38 - Kati i 3 (Trete)- Hyrja n°1/Ap. n°3
Tirane, Shqiperi